

# Organizimi në stallën e derrave

*Përgatitur nga Franz Riegler, Konsulent i Schaumann dhe aksioner i Austria Praemix shpk.*

*Përkthyer dhe përpunuar nga Olger Nanagjoka*



*Rritja e derrave: Dosat dhe gicat gjatë lindjes dhe periudhës së pirjes, kanë nevojë për një vend të pastër me hapsirë të mjaftueshme e me temperaturë konstante. Kafazet shërbejnë si mjet mbrojtës kundër shtypjeve të larta.*

---

Stalla e pjelljes është e veçuar nga të gjitha zonat e tjera të prodhimit. Një klimë optimale e stallës, si dhe mbrojtja nga luhatjet ekstreme të temperaturës janë të rëndësishme për shëndetin dhe mirëqënien e kafshëve. Në këtë kontekst, boksi e gicave ka një rëndësi kryesore. Nga ana kontrolli i personit përgjegjës duhet të bëhet si gjatë procesit të pjelljes ashtu edhe gjatë periudhës së laktacionit. Kjo kërkon që krevatet e martenitetit si dhe kolibja e gicave të jenë sa më të dukshme nga syri i njeriut gjithashtu dhe klima të jetë sa më optimale. Kontrolli dhe pastrimi i lugut të ushqimit dhe pirësës së ujit duhet të kryhet lehtë dhe pa shumë shpenzime ashtu si edhe pastrimi dhe dezinfektimi pas shkëputjes. Në stallë tufa e gicave vendoset në krah të dosës (sipas

planifikimit të standardeve aktuale). Në stallë me planimetri të drejtë, kolibja e gicave vendoset në krahë të dosës.

Në stallë të ndërtuar me planimetri të zhdrejtë, trogu i ushqimit të dosës montohet në cep të boksit të lindjes ndërsa kolibja e gicit përbri lугut.

Kafazi duhet të jetë i lidhur dhe i fiksuar si dhe i adaptueshëm me gjerësinë dhe gjatësinë e dosës. Hapësira maksimale duhet të jetë të paktën me gjatësi 190 cm nga lugu i ushqimit dhe gjerësi 65 cm. Klima e stallës duhet t'u përgjigjet nevojave të gicave. Mënyra optimale për ngrohjen e gicave bëhet me pllakë ngrohjeje nga poshtë, me energji elektrike ose me ujë të ngrohtë.

## Ajri i pastër



*Stallat e derrave: Rendimenti i lartë është i mundur vetëm nëse temperaturat dhe furnizimi me ajër të pastër plotëson nevojat e derrave. Në të kundërt duhet të merren masa: të përmirësohet izolimi, të rikuperohet nxehtësia e humbur dhe të ketë ngrohje shtesë.*

Për të shmangur lagështinë në shtresat izoluese të murit, duhet që tavanet dhe muret të ndërtohen në mënyrë të tillë që përshkueshmëria e avujve të ujit nga brenda jashtë dhe shtresë pas shtrese të rritet. Vetia izoluese e shtresave të murit (rezistenca termike) duhet të rritet gjithmonë nga brenda-jashtë. Nëse doni të llogarisni humbjen e nxehtësisë sot nuk përdoret më vlera “k” por “u” si parametër i përshkueshmërisë. Vlerat e ulta të “u”-së janë optimale ndërsa vlerat e larta tregojnë

për një izolim të keq termik. Përvoja tregon se muret dhe sidomos tavanet e stallave kanë humbje të mëdha të nxehtësisë: vlera e “u”-së duhet të jetë e ulët.

Që llogaritjet teorike të korrespondojnë me praktikën, duhet që të mos futet ajër nga të carat dhe plasaritjet, sidomos në ndërtesat e vjetra të stallave. Sasia e ajrit të freskët varet nga sezoni dhe pesha e kafshëve. Sistemi i ventilimit duhet të sigurojë këtë sasi edhe në kushte të pafavorshme pa shfaqur korente ajri në zonën ku rrinë kafshët. Gjithmonë dhe më shpesh në hapësirat e mëdha është provuar se mund të kombinohen shumë mirë dy sisteme: kanalet rrjedhëse dhe ventilimi. Përparësia e tavanit me pore qëndron në shmangien e kondensimit në dimër. Sistemet e ventilimit janë të përshtatshme për ndarjet e mëdha në periudhën e majmërisë përfundimtare, në të cilën zona e ndikimit është dezinfektim dhe larje totale, proces i cili nuk duhet të neglizhohet. Në shumicën e rasteve, kombinimi i dy sistemeve të ventilimit është mënyra më e mirë për ftohje, për të përmbushur kërkesat e kafshëve dhe për të mbrojtur mjedisin. Megjithatë pajisjet e kontrollit dhe funksionimi i tyre duhet të vazhdojë të zhvillohet më tej, sepse sot shumë ferma nuk përfitojnë nga pajisjet e tyre.

## **Tingujt në stallën e derrave**

*Studim: Një mjedis i larmishëm për derrat e majmërisë rrit gjithashtu cilësinë e mishit.*

---

Kjo u zbulua nga një studim i institutit të kërkimeve biologjike në kafshët e fermës në Dummerstorf, Gjermani. Derrat që lëvizin më shumë, ndërtojnë vazhdimisht fije muskulore që përmbajnë më shumë mioglobinë dhe janë më të kuqe. Që kafshët të lëvizin sa më shumë, studiuesit kanë vendosur në bokset e derrave tasa ushqimi me tinguj melodie. Me ndihmën e një tingulli të ngjashëm me zilen e një telefoni celular, kafshët afrohen dhe ushqehen me ushqim tetë herë në ditë.

Secilës kafshë i caktohet një melodi individuale në mënyrë që vetëm kjo kafshë të ushqehet në automatet e ushqimit dhe pa u shqetësuar nga kafshët e tjera. Në këtë mënyrë kafshët janë të zënë, ka më pak stres gjatë ushqyerjes dhe më pak konkurrencë për ushqim.

Për më shumë informacione mund të kontaktoni konsulentin tonë në numrin: 068 40 26 311